



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1021/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Lab-Oil shpk nga fshati Preoc në Graçanicë kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Inspektorati i Tregut me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.316/22 të datës 01.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit Lab-Oil nga fshati Preoc-Graçanicë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.316/22 i datës 01.03.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.316/22 të datës 01.03.2024, është Refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Lab-Oil nga fshati Preoc-Graçanicë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit nr.ref.19/20 dates 24.03.2020 dhe vendimit ref.19 dt.08.04.2020 i nxjerr nga i padituri Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Inspektorati i Tregut me seli në Prishtinë

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, të Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.316/22 të datës 01.03.2024, ashtu që kërkespadia e paditësit të aprovohet dhe të anulohen vendimet e të paditures.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike me vendimin përfundimtar nr.ref.19 i datës 08.04.2020, ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit Lab Oil shpk me drjtor Raif Gashi , dhe ka lën në fuqi aktvendimin nr.1596 dt.24.03/2020 i nxjerr nga Inspektorët e Tregut MEPTINIS

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 13.05.2020, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit e paraqitur kundër vendimit të paditures, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 27.02.2023, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetimin se sipas dispozitave ligjore inspektorati i tregut ka të drejt që ti lejoj një subekti ekonomik që në afatin e caktuar nga ai, t,ia dorzoj dokumentet, në të cilat ka kërkuar qasje por që ka munguar me rastin e inspektimit. Meqenëse paditësi nuk i ka dorzuar me kohë inspektoratit të tregtisë dokumentin e kërkuar, atëher inspektorati me të drejt i ka shqiptuar gjobë me aktin administrativ. Gjykata konstaton se i padituri në mënyrë të plotë dhe të drejt ka vërtetuar gjendjen faktike. Gjykata vnedimin e referon në nenin 14, 33 të Ligjit 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikqyrjen e Tregut.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikqyrjen e Tregut.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 182. 1 dhe 2 pika (n) dhe neni 183 të LPK-së, ngase gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar faktet kontestsuese se padiëtsi në afatin e dhënë prej 8 ditësh e ka bërë dërgimin e mostrave përmes e-mailit që gjendet në lëndë. Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Kolegji vlerësoi se e paditura respektivisht inspektorati i tregut gjatë inspektimit të kryer me datën 12.03.2020 tek paditësi, ka përpiluar procesverbalin duke konstatuar se paditësi nuk posedon qertifikaten e cilësisë për mostrat e marrur, dhe obligon të njëjtin që brenda 8 ditësh ta prezantoj dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë dhe e paditura nuk mund ta pranoj provën respektivisht e-mailin derguar inspektores SH.B.A., si dëshmi se ky e-mail përmban dokumentin e kërkuar nga inspektorati i tregut. Kolegji nga shkresat e lëndës konstaton se ky e-mail nuk është konfirmuar se është pranuar nga zyrtarët e paditues, prandaj me të drejtë e paditura në bazë të autorizimeve ligjore nga neni 13 të Ligjit 04/L-186 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikqyrjen e Tregut, i shqipton gjobën administrative paditësit për shkak të shkeljeve ligjore nga neni 14 i ligjit bazik L-03/L-181.

Edhe kjo gjykatë i vlerëson si të drejta dhe të bazuara konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, se paditësi nuk ka dorëzuar dokumentin e kërkuar nga e paditura, dhe arsyetimin e aktgjykimit e referon në dispozitat e nenit 14 të Ligjit 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikqyrjen e Tregut, që parashohin obligimin e subjektit ekonomik që ti mundësohet inspektoratit mbikqyrjen inspektuese, dhe ti ofroj të dhënat e nevojshme branda afatit të caktuar nga inspektori.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që Dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallës së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1021/24 datë 29.06.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha